

EU4 DGJAKSH - EU4 Drejtësia Gjithëpërfshirëse për Aftësinë e Kufizuar në Shqipëri

Fuqizimi i rolit dhe kapaciteteve të organizatave mbrojtëse të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara për t'u angazhuar efektivisht në forcimin e kuadrit ligjor për rritjen e aksesit në drejtësi dhe barazisë përpara ligjit për personat me aftësi të kufizuara, nëpërmjet ndikimit në sistemin e një drejtësie miqësore, institucioneve të drejtësisë të aksesueshme, procedurave të aksesueshme dhe ndihmës ligjore falas të aksesueshme dhe efektive.



Financuar nga
Bashkimi Evropian



Zbatues të projektit:

Fondacioni shqiptar për të drejtat e personave me afësi të kufizuara (FSHDPK),
Shoqata Kombëtare Shqiptare e Njerëzve që nuk Dëgjojnë (ANAD);
Fondacioni Down Syndrome Albania (DSA).

Periudha e zbatimit:
30 muaj



Partnerë:
Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas,
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale



Shtrirja e projektit:

5 Bashki:

Tiranë, Elbasan, Durrës, Shkodër, Korçë



Fushat kryesore të ndërhyrjes:



Ndikim në politikë dhe legjislacion: Propozimi i ndryshimeve ligjore, monitorimi i legjislacionit dhe sigurimi i përputhjes me Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Standardet e BE-së, bashkë me hartimin e udhëzimeve dhe udhërrëfyesve për institucionet përgjegjëse.



Qasje gjithëpërfshirëse: Rritja e aftësive të grupeve të interesit të sistemit të drejtësisë, organizatave dhe aktivistëve për të nxitur qëndrime, sjellje dhe reagime më të mira në lidhje me njohjen e barabartë përpara ligjit dhe aksesin në drejtësi.



Edukimi mbi Ligjin: Edukimi i individëve me aftësi të kufizuara dhe komuniteteve të tyre për të drejtat dhe detyrimet e tyre sipas ligjit, duke përfshirë përdorimin e platformave online të ndihmës juridike.



Aksesi në Drejtësi: Ofrimi i shërbimeve ligjore falas për personat me aftësi të kufizuara, si nëpërmjet internetit, ashtu edhe fizikisht, për të siguruar akses të barabartë në drejtësi.



Aksesueshmëria: Përshtatja e informacionit ligjor dhe e materialeve të projektit në formate të aksesueshme për individët me aftësi të kufizuara.

Rezultatet:



- ✓ **2000** individë me aftësi të kufizuara të mbështetur me informacion të përshtatur dhe të aksesueshëm.
- ✓ Mbështetje për **40 OJF/DPO** dhe **15 aktivistë të aftësisë** së kufizuar përmes programeve/trajnimeve të përshtatura arsimore.
- ✓ Ngritja e kapaciteteve për **220 anëtarë stafi** të autoritetet përkatëse publike/private të sistemit të drejtësisë, përmes **11 sesioneve trajnuese**.
- ✓ Trajnim për shkrim e këndim teknik për **120 persona me aftësi të kufizuara**, për të lehtësuar përdorimin e platformave interaktive online dhe të aksesueshme të ndihmës juridike.
- ✓ Sigurimi i ndihmës juridike falas të lëvizshme/në kushte shtëpie dhe online për **900** përfitues, **persona të marginalizuar me aftësi të kufizuara**.
- ✓ Zbatimi i të paktën **2 ndryshimeve ligjore** për harmonizimin e legjislacionit për aftësinë juridike për personat me aftësi të kufizuara.
- ✓ Krijimi i **1 shënimi udhëzues**, **2 fletë të dhënash** dhe **2 dokumente** të disponueshme në formate alternative dhe të aksesueshme (p.sh., leximi i lehtë, audio, gjuha e shenjave).
- ✓ Përgatitja e **1 raporti monitorues**, duke përfshirë auditim të aksesueshmërisë në ambiente si gjykata, komisarate, qendra dhe klinika ligjore që ofrojnë ndihmë juridike.